

VENDIM
Nr. 175, datë 23.8.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TERFOJA”

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a” dhe “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a” dhe “e”, të nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.8.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 113/3 prot., datë 16.8.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HEC Terfoja’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Terfoja’ dhe veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 879 prot., datë 11.8.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja”.

- Nga aplikimi i shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k. vërehet se nuk është kryer pagesa e aplikimit për licencim për këtë veprimtari, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, dhe është përcjellë kryesisht dokumentacion për nevojat të këtij aplikimi.

- Bazuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2, dhe në nenin 9, pika 3, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, duke qenë se nuk është kryer pagesa e aplikimit për licencim për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, atëherë dhe dokumentacioni i depozituar nuk mund të merret në shqyrtim nga ana e ERE-s.

- Në mbështetje të parashikimit të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit, dhe dokumentacioni i paraqitur nga ai për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri, i cili duhet të përmbajë bashkëlidhur edhe pagesën e aplikimit për licencim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti